



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:012196
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424355
PML.nr.159/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të pandehurit D. S., nga P., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni nga neni 267, paragrafi 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.3/2024 të datës 09.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të të pandehurit, D. S., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.3/2024 të datës 09.02.2024, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet menjëherë sot për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin Ppr.Kr.nr.3/2024 të datës 09.02.2024, të pandehurit D. S., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni nga neni 267, paragrafi 1, KPRK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t'i llogaritet nga data 12.02.2024 e deri me datën 12.03.2024. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pikat: 1.2.1, 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit D. S., avokati Afrim Paçarizi nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pikat:1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën, të ndryshoj vendimin e atakuar me kërkesë, të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.66/24 e datës 06.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

-kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimi i atakuar me kërkesë duhen ndryshuar dhe se i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se aktvendimi i atakuar është i paqëndrueshëm, për çka me të drejt tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vazhdimit të paraburgimit nuk ka dhënë arsye të qarta, relevante dhe të pranueshme sa i përket arsyeve - kushteve të veçanta ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit, por vetëm ka parafrazuar dispozitat ligjore, pa i mbështetur fare përfundimet e tyre në rrethana ligjore, e që vendimin e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm. Në rastin konkret del se bazat për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit kanë pushur së ekzistuari, andaj edhe si të tilla nuk qëndrojnë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar nuk vazhdojnë të qëndrojnë, se i pandehuri do të mund të ikë-arratiset, të ndikojë në sigurimin e provave apo rezultatet përkatëse të provave materiale, sepse nuk është as edhe një indikacion konkret dhe real se i pandehuri do të mund të ikë. Po ashtu nuk ekziston arsye se i pandehuri ka mundësinë e ndikimit në rezultatin e ekzaminimit të provave (mostrave të dyshuara të substancave narkotike), meqë të njëjtat tani më ndodhen në ekzaminim në institutin përkatës dhe kjo duke e ndërlidhur me faktin se i pandehuri ka shprehur gatishmërinë e tij që të pranoj fajësinë. Pra nga e gjithë kjo del se në rastin konkret, nuk rezulton e bazuar frika e justifikuar për mundësinë ikjes, nxjerrjen-asgjësimit të provave, ndikimit në ekspertizën dhe as në përsëritjen e veprës penale.

Andaj kjo gjykatë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimi i kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit. Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes pati parasysh dhe aplikoi dispozitën e nenit 171 par.3 të KPP-së, se masat e përcaktuara hiqen kur pushojnë shkaqet për të cilat janë caktuar e që në rastin konkret bazuar në shkresat e lëndës del se masa e paraburgimit duhet të hiqet, meqë kanë pushuar shkaqet dhe arsyet për të cilat ishte vazhduar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Për këtë arsye, kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës, konform nenit 438 par. 1 pika 1.1 të KPP, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.159/2024, më datë 07.03.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi